

dueshëm, sëmundjet periodontale përgjigjen mirë ndaj trajtimit dhe menaxhohen me sukses. Është e rëndësishme për dentistin të ketë informacion nëse ka shfaqje të kësaj sëmundje në familjen tuaj.



Predispozita gjenetike

Ka evidence të rëndësishme që trashëgimia mund të kontribuojë në zhvillimin e sëmundjeve periodontale. Gingivitet shfaqen dhe në paciente me çrregullime të trashëgueshme të ndryshme. Forma specifike të gingiviteve në të rinj kanë predispozitë të theksuar gjenetike. Gjithashtu ka të dhëna që periodontitet tek adultët kanë influencë gjenetike. Nëse prindërit ose kushërinjtë tuaj kanë patur probleme periodontale, ju keni faktor rrisht të lartë për këte patologji.

Probabiliteti i shfaqjes së periodontiteve rritet me numrin e faktorëve riskues të pranishëm. Disa faktorë



si trashëgimia nuk mund të ndryshohen, sidoqoftë njohja me këto faktorë është e rëndësishme për parandalimin e sëmundjes dhe trajtimin e suksesshëm.

Higjiena e mirë orale, lënia e duhanit, dhe ndjekja e instruksioneve të dentistit tuaj në lidhje me vizitat e rregullta për ekzaminimin dhe trajtimin e vazhdueshëm janë të rëndësishme për përmirësimin e sëmundjeve periodontale.

Këto janë disa çështje që mund ti diskutoni me dentistin tuaj:

1. A përdorni fillin dentar?
2. Ka nëna ose babai juaj sëmundje periodontale?
3. Në familjarët e tu ka individë që vuajnë nga diabeti?
4. Pini duhan?
5. Gjakosen gingivat tuaja?




SHOQATA DENTARE SHQIPTARE

SI TË ZVOGËLOJMË RISKUN E SËMUNDJEVE PERIODONTALE?

Fjala **periodont** ka kuptim “përreth dhëmbit”. Sëmundjet periodontale janë infeksione serioze bakteriale që shkatërrojnë fibrat lidhëse dhe kockën ku mbështeten dhëmbët.

Në rreth 20-30% të pacientëve mund të shfaqen forma të avancuara të sëmundjeve periodontale të cilat nëse nuk trajtohen sjellin humbje të dhëbëve.



www.shdsh.org

Shkaktari kryesor i sëmundjeve periodontale është infeksioni nga pllaka bakteriale, një shtresë ngjitëse, e ngjyrosur që formohet në sipërfaqet e



dhëmbëve. Kushte të caktuara favorizojnë shfaqjen e sëmundjeve periodontale.

Përdorimi i duhanit

Përdorimi i duhanit lidhet me sëmundje serioze si: kanceri, sëmundjet e mushkërisë dhe sëmundjet e



zemrës, ashtu si shumë sëmundje të tjera serioze. Përdoruesit e duhanit kanë risk të lartë për shfaqjen e sëmundjeve periodontale. Duhanpirësit kanë tendencë të kenë forma më të avancuara të patologjive peri-



odontale dhe i përgjigjen më pak formave mjekuese në krahasim me jo-duhanpirësit.

Probabiliteti i shfaqjes së sëmundjes varet nga sasia e konsumimit të duhanit. Shanset në duhanpirësit aktual janë më të mëdha në krahasim



me ish-duhanpirësit. Duhani konsiderohet si faktor i rëndësishëm për sëmundjet periodontale. Lënia e duhanit ndikon në ruajtjen e shëndetshme të dhëmbëve.

Diabeti Melitus

Diabeti është një sëmundje që shkakton nivele të ndryshme të sheqerit në gjak.

Nëse jeni një diabetik, ju keni një risk më të lartë për të zhvilluar infeksione, si sëmundjet periodontale. Probabiliteti i shfaqjes rritet kur pacienti diabetik nuk kontrollohet. Infeksionet, si gingivitët mund të komplikojnë kontrollin e diabetit dhe të shfaqen si forma më të rënda të gingiviteve se në pacientët jo diabetikë.

Për diabetikët që janë në kontroll të vazh-